

Dokës-tizazno

Nr. II-303  
Br.

Data 07.04.2020  
Datum



REPUBLIKA E KOSOVË  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC



Në bazë të nenit 17 pika g të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 18 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, nenit 4 paragrafi 4.1 dhe nenit 8 paragrafi 2 shkronja d) e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/07 datë 13.03.2020, Vendimit nr II-186 datë 13.03.2020 për formimin e Shtabit emergjent komunal për parandalimin e COVID-19 në Komunën e Obiliqit, nenit 37 pika 1.7 të Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.-I- 34 datë 25.04.2016, Shtabi emergjent komunal për parandalimin e COVID-19 në Komunën e Obiliqit nxjerrë këtë:

## VENDIM

- I. **MIRATOHET** Vendimi për marrjen e masave për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 i njohur edhe si Virusi Korona, në KOMUNËN E OBILIQIT.
- II. **OBLIGOHEN** të gjitha dyqanet e shitjes së produkteve ushqimore dhe jo ushqimore, në Komunën e Obiliqit që në baza të rregullta / vazhdimisht gjatë ditës të dezinfektojnë, të gjitha karrocet dhe shportat me të cilat shërbehen qytetarët e komunës për bartjen e produkteve ushqimore dhe produkteve tjera, dhe të njëjtën duhet ta dëshmojnë me raporte përkatëse të kompanive të dezinfektimit.
- III. **OBLIGOHEN** të gjitha bizneset industriale dhe komerciale me theks te veçantë bankat dhe bizneset tjera të cilat si veprimtari të tyre e kanë realizimin e pagesave të ndryshme që vazhdimisht të bëjnë dezinfektimin e hapësirave ku i ofrojnë shërbimet e tyre dhe të njëjtën duhet ta dëshmojnë me raporte përkatëse të kompanive të dezinfektimit.
- IV. **OBLIGOHEN** të gjitha bizneset të cekura ne pikat II dhe III të këtij vendimi të cilat operojnë në Komunën e Obiliqit që të caktojë një person përgjegjës i cili do të merret me respektimin e distancës së klientëve gjatë ofrimit të shërbimeve të tyre.

- V. Bizneset të cilat veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi do të gjobiten në bazë të legjislacionit në fuqi.
- VI. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Shtabi për Parandalimin e COVID-19 në Komunën e Obiliqit, Drejtoria e Inspektionit, DSHMS.
- VII. Zyra për Informim do t'i i njoftojë qytetarët dhe subjektet tjera për këtë vendim.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

T'i dorëzohet:

- Shtabit për parandalimin e COVID-19
- DEFZH
- Drejtorisë së Inspektionit
- Zyrës për Informim
- Arkivës

Shtabi për Parandalimin e COVID-19

Kryetari i Komunës

Xhafer Gashi

